



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 971/ 6 prot.

Datë 07/05/2025

V E N D I M
Nr. 631/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/05/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “KLAME” SHPK me NIPT K21518003F dhe me adresë: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Universiteti i Mjekësisë Tiranë
Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 31.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt:

“Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

II.2. Në datën 13.02.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

II.3. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues ankimuesit “KLAME” SHPK dhe verifikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se në datën 19.03.2025, në rubrikën “Mesazhe” anëtari i komisioni të vlerësimit të ofertave znj. N. D nëpërmjet këtij sistemi i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues sqarime si më poshtë vijon:

“Përshëndetje,

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është duke zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”. Ju jeni operator ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga ana juaj është konstatuar se sipas ekstraktit historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit e ushtroni aktivitetin në adresën Tiranë Tiranë Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I, dhe na keni paraqitur një kontratë qiraje të nënshkruar mes palëve dhe jo para noterit, ku në nenin 3 afati citohet se: “Kjo kontratë është e vlefshme nga data XX.XX.XXXX deri në datën XX.XX.XXXX. Pas përfundimit të këtij afati kontrata zgjatet dhe për një afat 1 vjeçar me të njëjtat kushte...”.

Ndodhur në këto kushte me shkresën nr. XXXX/XX prot., datë XX.XX.XXXX i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga ana juaj.

Nëpërmjet shkresës së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nr. XXXX/X prot., datë XX.XX.XXXX me lëndë: “Kthim Përgjigje”, jemi informuar për sa më poshtë:

“Për tatimpaguesin KLAME me numër NIPT K21518003F nuk mund t’ju japim informacionin e kërkuar mbi situatën e detyrimeve të datës 13 Shkurt 2024, sepse sistemi tatimor nuk na e lejon këtë akses, por mund të japim me siguri situatën e detyrimeve në kohë reale të datës 17.03.2025, ku rezulton me totalin e detyrimeve prej X lekë, nga të cilat X lekë janë detyrime te Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe X lekë janë detyrime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Nga verifikimi në sistemin tatimor informativ c@ts, vihet re se në rubrikën “Dokumente” nuk është e ngarkuar kjo kontratë dhe nuk është e deklaruar. Vihet re se për afatin e nënshkruar në kontratë prej datës XX.XX.XXXX - XX.XX.XXXX, subjekti ka dorëzuar të gjitha deklaratat, por deklarimi nuk është i saktë dhe i rregullt. Vihet re gjithashtu se ka disa deklarata për disa muaj që ka kaluar Vlerësim nga Inspektori Tetor 2023-Shkurt 2024. Për deklaratën e muajit Dhjetor 2023 është dorëzuar nga Inspektori deklarata me Vlerën “[15] Pagesa për qeratë” X lekë dhe

15 % tatimit prej X lekë. Në muajin shkurt 2024, X lekë dhe 15 % , X lekë. Deklarimet e muajve të tjerë janë të dorëzuar me vlerë 0 lekë”.

Sa më sipër, bazuar në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**, “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, tek sqarime nëse vlerësohet e nevojshme nga ana juaj është shkruar: “(<https://e-albania.al/> me dokument lëshuar nga MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE/DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE-Vertetim Për pagim Detyrimesh)”. Referuar vetëdeklarimit dhe përgjigjes së cituar më lartë, për të na verifikuar gjendjen tuaj faktike në kohën e ofertimit më datë 13 Shkurt 2025, brenda ditës së premte, datë 21 Mars 2025, kërkojmë të dorëzoni dokumentacioni justifikues në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe protokollin e institucionit.”.

II.4. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues ankimuesit “KLAME” SHPK dhe verifikimeve në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se në datën 21.03.2025, në rubrikën “Mesazhe” në vijim të kërkesës së mësipërme të komisionit të vlerësimit të ofertave, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nëpërmjet këtij sistemi i ka dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Vërtetim (Për pagim detyrimesh) nr; TXXXXXX, datë XX.XX.XXXX, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nëpërmjet sistemit E-Albania me vulë elektronike, ku pasqyrohet, si më poshtë vijon;

“Vërtetohet se:

Z./Znj. G.SH

Tatimpaguesi: KLAME

NIPT-i: K21518003F

Aktiviteti: Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi,

Adresa: Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I

Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën: 21.03.2025 ora 08:19:56”.

- Njoftim Debitimi/ Debit Advice, date XX.XX.XXXX, lëshuar nga XXXX Bank, për klientin urdhëruar “KLAME” SHPK, i cili ka paguar për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, detyrimin për tatimin mbi vlerën e shtuar, në vlerën X leke.

- Urdhër pagese për tatimin mbi vlerën e shtuar nr: XXXXXXXXXX, për periudhën tatimore dhjetor 2024, të subjektit “KLAME” SHPK, për vlerën X leke,

- Pagesë tatime dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin dhjetor 2024, të klientit “KLAME” SHPK në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në vlerën X leke, lëshuar nga X Bank

- Urdhër pagese për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nr: XXXXXXXXXX, PËR PERIUDHËN TATIMORE DHJETOR 2024, të subjektit “KLAME” SHPK, për vlerën X leke.

- Vërtetim (Për pagim detyrimesh) nr; TXXXXXX, datë XX.XX.XXXX, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë nëpërmjet sistemit E-Albania me vulë elektronike, ku pasqyrohet, si më poshtë vijon:

“Vërtetohet se:

Z./Znj. G. SH

Tatimpaguesi: KLAME

NIPT-i: K21518003F

Aktiviteti: Prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhimin e artikujve prej xunkthi,

Adresa: Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I

Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor te papaguar deri më datën: 17.12.2024 ora 07:14:22”.

II.5. Më datë 27.03.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“Bajro Bros” ShPK	0,00	leke	skualifikuar
2	“KLAME ” ShPK	13.663.400,00	leke	skualifikuar
2	“DEUTSCHCOLOR ” ShPK	14.138.000,00	leke	skualifikuar
4	“BOLT ” ShPK	20.690.800,00	leke	kualifikuar
5	“ERALD ” ShPK	21.158.090,00	leke	skualifikuar
6	“BUNA ” ShPK	22.040.200,29	leke	kualifikuar
7	“M.LEZHA ” ShPK	22.265.162,00	leke	kualifikuar

II.6. Në datën 27.03.2025, operatori ekonomik “KLAME” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik lidhur me dokumentacionin për ambientin ku ushtron veprimtarinë, ka paraqitur një kontratë qiraje të nënshkruar mes palëve dhe jo para noterit, ku në nenin 3 afati citohet se: “Kjo kontratë është e vlefshme nga data 21.10.2023 deri në datën 20.10.2024. Pas përfundimit të këtij afati kontrata zgjatet dhe për një afat 1 vjeçar me të njëjtat kushte...”

Afati i kontratës ka përfunduar më datë 20.10.2024.

Lidhur me vlefshmërinë dhe provueshmërinë e këtij dokumenti, bazuar në nenin 803 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar ku citohet: “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë” si dhe në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenin 33, gërma ë), të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetet, duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore një kopje të kontratës së qerasë apo të kontratës së pronësisë së ambientit si dhe tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitetet në ambientet e marra me qera duhet të llogaritin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore, tatimin në burim deri në datën 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës së qerasë, i jemi drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 3106/31 prot., datë 26.02.2025.

Nga shkresa e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nr. 4694/1 prot., datë 17.03.2025 me lëndë: “Kthim Përgjigje”.
jemi informuar për sa më poshtë: “Nga verifikimi në sistemin tatimor informativ c@ts, vihet re se në rubrikën “Dokumente” nuk është e ngarkuar kjo kontratë dhe nuk është e deklaruar. Vihet re se për afatin e nënshkruar në kontratë prej datës 21.10.2023-20.10.2024, subjekti ka dorëzuar të gjitha deklaratat, por deklarimi nuk është i saktë dhe i rregullt. Vihet re gjithashtu se ka disa deklarata për disa muaj që ka kaluar Vlerësim nga Inspektori Tetor 2023-Shkurt 2024. Për deklaratën e muajit Dhjetor 2023 është dorëzuar nga Inspektori deklarata me Vlerën “[15] Pagesa për qeratë” 756,000 lekë dhe 15 % tatimit prej 113,400 lekë. Në muajin shkurt 2024 126,000 lekë dhe 15 % 18,900 lekë. Deklarimet e muajve të 3 tjerë janë të dorëzuar me vlerë 0 lekë”. Kjo kontratë bazuar dhe në përgjigjen e institucionit kompetentë është e pa deklaruar dhe jo e regjistruar duke e bërë të pavlefshme dhe jo të rregullt, si dhe nuk ka deklarim të kryer për tatimin në burim për vlerën e qirasë të deklaruar në nenin 4 të sajë: “Pagesa mujore për qeramarrjen është 10.000 lekë në muaj...”

Gjithashtu në shkresën e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nr. 4694/1 prot., datë 17.03.2025 jemi informuar se:
“Për tatimpaguesin KLAME me numër NIPT K21518003F nuk mund t’ju japim informacionin e kërkuar mbi situatën e detyrimeve të datës 13 Shkurt 2024, sepse sistemi tatimor nuk na e lejon këtë akses, por mund të japim me siguri situatën e detyrimeve në kohë reale të datës 17.03.2025, ku rezulton me totalin e detyrimeve prej 97,244 lekë, nga të cilat 11,278 lekë janë detyrime të Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 85,966 lekë janë detyrime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.”

Operatori ekonomik në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, tek sqarime nëse vlerësohet e nevojshme nga ana juaj është shkruar: “(https://e-albania.al/ me dokument lëshuar nga MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE/DREJTORIA RAJONALE E

TATIMEVE TIRANE-Vertetim Për pagim Detyrimesh)”, ndërkohë që ky operator rezulton me detyrime tatimore gjorbë e regjistruar për TVSH 62,455 dhe interes i regjistruar për TVSH 23,510.

Operatori ekonomik është bërë me dije nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe e-mailit zyrtar, më datë 19.03.2025 lidhur me hetimin e kryer dhe provueshmërinë nga ana e tij gjendjes faktike në kohën e ofertimit. Nga ana e operatorit ekonomik nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument që justifikon gjendjen faktike të detyrimeve tatimore në ditën e ofertimit, bazuar në pikën 6, neni 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se: “Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij”; Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k. nuk kualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit”.”.

II.7. Më datë 03.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

II.8. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025 dhe me numër protokolli nr. 971/2025 datë 14.04.2025 e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “KLAME” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 971/1 Prot, datë 15.04.2025, në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori “KLAME” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Në datë 24.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën nr. 3106/46 prot, datë 24.04.2025, “Mbi ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “KLAME” sh.p.k, me numër ankimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë,

Tiranë. '.”, protokolluar me tonën me nr. 971/2 prot, datë 24.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

“Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar-Mallra" Prokurim me mjete Elektronike, me numër REF-34898-12-30-2024, me fond limit: 22,490,000 (njetetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) Leke pa TVSH. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave për këtë procedurë ka qwnë data 13.02.2025. Më date 27.03.2025 është realizuar vlerësimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Më datë 02.04.2025 është ngarkuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraprak, i cili është publikuar më datë 03.04.2025. Afati i ankimit për vlerësimin e ofertave për këtë procedurë bazuar në pikën 2 të nenit 110, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ka qënë brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Bazuar në nenin 111 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pikës 4, neni 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ankesës online A/2025/5240 nga operatori ekonomik "KLAME" SH.P.K., protokolluar me nr. 3106/43 prot., datë 14.04.2025, Urdhrit të pezullimit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 54, datë 15.04.2025, "Për procedurën me objekt: "Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" protokolluar me nr. 3106/44 prot., datë 15.04.2025, nga ana e Komisionit është konstatuar se operatori ekonomik e ka paraqitur ankesën më datë 14.04.2025.

Ankesa është paraqitur për Dokumenta Tenderi dhe jo për vlerësimin e ofertave. Bazuar në pikën 2/a dhe 2/b të Vendim Nr. 236, datë 20.4.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik", ku citohet: "Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet;

b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet", është konstatuar se operatori ekonomik ka kryer pagesën 89,960 lekë prej 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit për dokumentet e tenderit dhe jo vlerën që duhet të paguante 112,450 prej 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit për vendimin e vlerësimit.

Më datë 16.04.2025 nëpërmjet e-mailit është bërë me dije operatori ekonomik dhe Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me diferencën në vlerë të pagesës së kryer.

Më datë 18.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike i është dërguar kërkesë operatorit ekonomik lidhur me paraqitjen e mandat pagesës.

Më datë 24.04.2025 në Sistemin e Ankesave Elektronike në orën 07:14 dhe 07:15 konstatohet se janë ngarkuar disa herë mandat pagesa dhe mandate arkëtimi të datës 14.04.2025.

Për arsye se brenda afatit dy ditor nga njoftimi në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk është paraqitur diferenca prej 22,490 lekë, kjo ankesë është vlerësuar si e paparaqitur.

Bashkëngjitur kesaj shkrese do të gjeni dokumentacionin:

Mandat pagesë nr. 88, date 14.04.2025	1 (një) faqe;
Pagese për Thesarin datë 14.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili nga KPP lidhur me ankesën e paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP dhe operatorit ekonomik nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 16.04.2025	1 (një) faqe;
Kërkesa drejtuar operatorit ekonomik në Sistemin e Ankesave Elektronike, datë 18.04.2025,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 1:31 pm,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 4:09 pm,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 24.04.2025, ora 9:58 am,	1 (një) faqe;
Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor faqja e Sistemit të Ankesave Elektronike datë 24.04.2025, ora 10:01 am,	1 (një) faqe;”.

II.11. Në datë 25.04.2025, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3106/46 prot, datë 24.04.2025, “Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k, me numër ankimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.’”, protokolluar me tonën me nr. 971/2 prot, datë 24.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

“Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar-Mallra” Prokurim me mjete Elektronike, me numër REF-34898-12-30-2024, me fond limit: 22,490,000 (njetetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) Leke pa TVSH. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave për këtë procedurë ka qwnë data 13.02.2025. Më date 27.03.2025 është realizuar vlerësimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Më datë 02.04.2025 është ngarkuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraprak, i cili është publikuar më datë 03.04.2025. Afati i ankimit për vlerësimin e ofertave për këtë procedurë bazuar në pikën 2 të nenit 110, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka qënë brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Bazuar në nenin 111 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pikës 4, neni 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ankesës online A/2025/5240 nga operatori ekonomik "KLAME" SH.P.K., protokolluar me nr. 3106/43 prot., datë 14.04.2025, Urdhrit të pezullimit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 54, datë 15.04.2025, "Për procedurën me objekt: "Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" protokolluar me nr. 3106/44 prot., datë 15.04.2025, nga ana e Komisionit është konstatuar se operatori ekonomik e ka paraqitur ankesën më datë 14.04.2025.

Ankesa është paraqitur për Dokumenta Tenderi dhe jo për vlerësimin e ofertave. Bazuar në pikën 2/a dhe 2/b të Vendim Nr. 236, datë 20.4.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik", ku citohet: "Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet;

b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet", është konstatuar se operatori ekonomik ka kryer pagesën 89,960 lekë prej 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit për dokumentet e tenderit dhe jo vlerën që duhet të paguante 112,450 prej 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit për vendimin e vlerësimit.

Më datë 16.04.2025 nëpërmjet e-mailit është bërë me dije operatori ekonomik dhe Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me diferencën në vlerë të pagesës së kryer.

Më datë 18.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike i është dërguar kërkesë operatorit ekonomik lidhur me paraqitjen e mandat pagesës.

Më datë 24.04.2025 në Sistemin e Ankesave Elektronike në orën 07:14 dhe 07:15 konstatohet se janë ngarkuar disa herë mandat pagesa dhe mandate arkëtimi të datës 14.04.2025.

Për arsye se brenda afatit dy ditor nga njoftimi në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk është paraqitur diferenca prej 22,490 lekë, kjo ankesë është vlerësuar si e paparaqitur.

Bashkëngjitur kesaj shkrese do të gjeni dokumentacionin:

Mandat pagesë nr. 88, date 14.04.2025	1 (një) faqe;
Pagese për Thesarin datë 14.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili nga KPP lidhur me ankesën e paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP dhe operatorit ekonomik nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 16.04.2025	1 (një) faqe;
Kërkesa drejtuar operatorit ekonomik në Sistemin e Ankesave Elektronike, datë 18.04.2025,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 1:31 pm,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 4:09 pm,	1 (një) faqe;

Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 24.04.2025, ora 9:58 am, 1 (një) faqe;
Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor faqja e Sistemit të Ankesave Elektronike datë
24.04.2025, ora 10:01 am, 1 (një) faqe;”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën me numër ankimimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025 dhe me numër protokolli nr. 971/2025 datë 14.04.2025 e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ku objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga ankimuesi, procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e plotë të tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet e pikës 2/b të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 236, datë 20.4.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, ku parashikohet se: “2. Për shqyrtimin e ankesës, operatori ekonomik ankimues detyrohet të paguajë pranë Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohe;

b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohe;

c) Kur ankesa paraqitet për pavlefshmërinë e kontratës, 0.5% të vlerës së kontratës së nënshkruar.”, si dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së

ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Në datën 31.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë.

III.1.3. Në datën 13.02.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt-ankimi.

III.1.4. Më datë 27.03.2025 autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave si vijon:

1	“Bajro Bros” ShPK	0,00	leke	skualifikuar
2	“KLAME ” ShPK	13.663.400,00	leke	skualifikuar
2	“DEUTSCHCOLOR ” ShPK	14.138.000,00	leke	skualifikuar
4	“BOLT ” ShPK	20.690.800,00	leke	kualifikuar
5	“ERALD ” ShPK	21.158.090,00	leke	skualifikuar
6	“BUNA ” ShPK	22.040.200,29	leke	kualifikuar
7	“M.LEZHA ” ShPK	22.265.162,00	leke	kualifikuar

III.1.5. Në datën 27.03.2025, operatori ekonomik “KLAME” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik lidhur me dokumentacionin për ambientin ku ushtron veprimtarinë, ka paraqitur një kontratë qiraje të nënshkruar mes palëve dhe jo para noterit, ku në nenin 3 afati citohet se: “Kjo kontratë është e vlefshme nga data 21.10.2023 deri në datën 20.10.2024. Pas përfundimit të këtij afati kontrata zgjatet dhe për një afat 1 vjeçar me të njëjtat kushte...”

Afati i kontratës ka përfunduar më datë 20.10.2024.

Lidhur me vlefshmërinë dhe provueshmërinë e këtij dokumenti, bazuar në nenin 803 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar ku citohet: “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë” si dhe në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenin 33, gërma ë), të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet, duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore një kopje të kontratës së qerasë apo të kontratës së pronësisë së ambientit si dhe tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet në ambientet e marra me qera duhet të llogaritin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore, tatimin në burim deri në datën 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës së qerasë, i jemi drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 3106/31 prot., datë 26.02.2025.

Nga shkresa e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nr. 4694/1 prot., datë 17.03.2025 me lëndë: “Kthim Përgjigje”, jemi informuar për sa më poshtë: “Nga verifikimi në sistemin tatimor informativ c@ts, vihet re se në rubrikën “Dokumente” nuk është e ngarkuar kjo kontratë dhe nuk është e deklaruar. Vihet re se për afatin e nënshkruar në kontratë prej datës 21.10.2023-20.10.2024, subjekti ka dorëzuar të gjitha deklaratat, por deklarimi nuk është i saktë dhe i rregullt. Vihet re gjithashtu se ka disa deklarata për disa muaj që ka kaluar Vlerësim nga Inspektori Tëtor 2023-Shkurt 2024. Për deklaratën e muajit Dhjetor 2023 është dorëzuar nga Inspektori deklarata me Vlerën “[15] Pagesa për qeratë” 756,000 lekë dhe 15 % tatimit prej 113,400 lekë. Në muajin shkurt 2024 126,000 lekë dhe 15 % 18,900 lekë. Deklarimet e muajve të 3 tjerë janë të dorëzuar me vlerë 0 lekë”. Kjo kontratë bazuar dhe në përgjigjen e institucionit kompetentë është e pa deklaruar dhe jo e regjistruar duke e bërë të pavlefshme dhe jo të rregullt, si dhe nuk ka deklarim të kryer për tatimin në burim për vlerën e qirasë të deklaruar në nenin 4 të sajë: “Pagesa mujore për qeramarrjen është 10.000 lekë në muaj...”

Gjithashtu në shkresën e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nr. 4694/1 prot., datë 17.03.2025 jemi informuar se: “Për tatimpaguesin KLAME me numër NIPT K21518003F nuk mund t’ju japim informacionin e kërkuar mbi situatën e detyrimeve të datës 13 Shkurt 2024, sepse sistemi tatimor nuk na e lejon këtë akses, por mund të japim me siguri situatën e detyrimeve në kohë reale të datës 17.03.2025, ku rezulton me totalin e detyrimeve prej 97,244 lekë, nga të cilat 11,278 lekë janë detyrime të Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe 85,966 lekë janë detyrime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.”

Operatori ekonomik në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet

e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, tek sqarime nëse vlerësohet e nevojshme nga ana juaj është shkruar: “(<https://e-albania.al/> me dokument lëshuar nga MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË/ DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE/DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE-Vertetim Për pagim Detyrimesh)”, ndërkohë që ky operator rezulton me detyrime tatimore gjobë e regjistruar për TVSH 62,455 dhe interes i regjistruar për TVSH 23,510.

Operatori ekonomik është bërë me dije nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe e-mailit zyrtar, më datë 19.03.2025 lidhur me hetimin e kryer dhe provueshmërinë nga ana e tij gjendjes faktike në kohën e ofertimit. Nga ana e operatorit ekonomik nuk është vënë në dispozicion asnjë dokument që justifikon gjendjen faktike të detyrimeve tatimore në ditën e ofertimit, bazuar në pikën 6, neni 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se: “Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij”; Operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k. nuk kualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në Dokumentat Standarde të Tenderit”.

III.1.6. Më datë 03.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak.

III.1.7. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025 dhe me numër protokolli nr. 971/2025 datë 14.04.2025 e operatorit ekonomik “KLAME” ShPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Gjithashtu nga verifikimi në Sistemin e Ankesave Elektronike u konstatua se po në datë 14.04.2025, operatori ekonomik ankimues “KLAME” ShPK ka bashkalidhur edhe mandat pagesën e datës 14.04.2025, të lëshuar nga X BANK, ku ka paguar në favor të Degës së Thesarit Tiranë për llogari të Komisionit të Prokurimit Publik “Garanci vitit vazhdim pr ankim hyra” në vlerën 89.960 (tetëdhjet e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjet) leke.

III.1.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit me Nr. 971/1 Prot, datë

15.04.2025, në lidhje me me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.9. Në datë 24.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresën nr. 3106/46 prot, datë 24.04.2025, *“Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k, me numër ankimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.’”,* protokolluar me tonën me nr. 971/2 prot, datë 24.04.2025, si dhe në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 3106/46 prot, datë 24.04.2025, *“Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k, me numër ankimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.’”,* protokolluar me tonën me nr. 971/2 prot, datë 24.04.2025, informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “KLAME” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke arsyetuar si më poshtë vijon:

“Autoriteti Kontraktor, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë", "Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar-Mallra" Prokurim me mjete Elektronike, me numër REF-34898-12-30-2024, me fond limit: 22,490,000 (njetetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) Leke pa TVSH. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave për këtë procedurë ka qwnë data 13.02.2025. Më date 27.03.2025 është realizuar vlerësimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Më datë 02.04.2025 është ngarkuar në SPE Njoftimi i Fituesit Paraprak, i cili është publikuar më datë 03.04.2025. Afati i ankimit për vlerësimin e ofertave për këtë procedurë bazuar në pikën 2 të nenit 110, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ka qënë brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Bazuar në nenin 111 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pikës 4, neni 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ankesës online A/2025/5240 nga operatori ekonomik "KLAME" SH.P.K., protokolluar me nr. 3106/43 prot., datë 14.04.2025, Urdhrit të pezullimit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 54, datë 15.04.2025, "Për procedurën me objekt: "Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë" protokolluar me nr. 3106/44 prot., datë 15.04.2025, nga ana e Komisionit është konstatuar se operatori ekonomik e ka paraqitur ankesën më datë 14.04.2025.

Ankesa është paraqitur për Dokumenta Tenderi dhe jo për vlerësimin e ofertave. Bazuar në pikën 2/a dhe 2/b të Vendim Nr. 236, datë 20.4.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik", ku citohet: "Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet;

b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet", është konstatuar se operatori ekonomik ka kryer pagesën 89,960 lekë prej 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit për dokumentet e tenderit dhe jo vlerën që duhet të paguante 112,450 prej 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit për vendimin e vlerësimit.

Më datë 16.04.2025 nëpërmjet e-mailit është bërë me dije operatori ekonomik dhe Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me diferencën në vlerë të pagesës së kryer.

Më datë 18.04.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike i është dërguar kërkesë operatorit ekonomik lidhur me paraqitjen e mandat pagesës.

Më datë 24.04.2025 në Sistemin e Ankesave Elektronike në orën 07:14 dhe 07:15 konstatohet se janë ngarkuar disa herë mandat pagesa dhe mandate arkëtimi të datës 14.04.2025.

Për arsye se brenda afatit dy ditor nga njoftimi në Sistemin e Ankesave Elektronike nuk është paraqitur diferenca prej 22,490 lekë, kjo ankesë është vlerësuar si e paparaqitur.

Bashkëngjitur kesaj shkresë do të gjeni dokumentacionin:

Mandat pagesë nr. 88, datë 14.04.2025	1 (një) faqe;
Pagese për Thesarin datë 14.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili nga KPP lidhur me ankesën e paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 15.04.2025	1 (një) faqe;
E-maili drejtuar KPP dhe operatorit ekonomik nga Autoriteti Kontraktor lidhur me mangësitë e ankesës së paraqitur, datë 16.04.2025	1 (një) faqe;
Kërkesa drejtuar operatorit ekonomik në Sistemin e Ankesave Elektronike, datë 18.04.2025,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 1:31 pm,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 23.04.2025, ora 4:09 pm,	1 (një) faqe;
Kontrolli i ankesës në kohë reale datë 24.04.2025, ora 9:58 am,	1 (një) faqe;

Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor faqja e Sistemit të Ankesave Elektronike datë 24.04.2025, ora 10:01 am, 1 (një) faqe;”.

III.1.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 3106/46 prot, datë 24.04.2025, *“Mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” sh.p.k, me numër ankimi elektronik A/2025/5240, datë 14.04.2025, për procedurën e prokurimit me objekt: ‘Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.’”, Komisioni konstaton, në datë 18.04.2025, ora 13:26 PM, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në rubrikën “Komunikime” autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues “KLAME” shpk, që të rregullojë të metat e ankesës, duke e njoftuar si më poshtë vijon:*

*“Përshëndetje,
Kërkoni mandat pagesën*

Në vijim dhe të komunikimit me e-mail me Komisionin e Prokurimit Publik dhe ju më datë 16.04.2025, për të cilin nuk kemi ende asnjë përgjigje, pasi konstatuam ndryshime në faqen zyrtare të KPP lidhur me ankesën e paraqitur, konkretisht: Tipi i ankesës ka ndryshuar nga "Dokumenta Tenderi" në "Vlerësim", dhe vlera e pagesës ka ndryshuar dhe ka dal statusi i mandat pagesës "Pa paraqitur", në zbatim të pikës 3, neni 111 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ju bëjmë me dije lidhur me korigjimin e të metave në ankesën e paraqitur nga ana juaj, konkretisht paraqitjen e mandat pagesës me vlerën e ndryshuar.”.

III.1.11. Nga verifikimet në Sistemin e Ankesave Elektronike, Komisioni konstaton se në përgjigje të kërkesës së datës 18.04.2025, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK ka dërguar nëpërmjet këtij sistemi mandat pagesën e datës 25.04.2025, të lëshuar nga X BANK, ku ka paguar në favor të Degës së Thesarit Tiranë për llogari të Komisionit të Prokurimit Publik *“Garanci vitit vazhdim pr ankim hyra”* në vlerën 22490 (njëzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjet) leke.

III.1.12. Referuar pikës 1 të nenit 109, si dhe pikës 1 e pikës 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar*

Të drejtën e operatorëve ekonomik për të paraqitur ankesë ndaj veprimeve apo mosveprimeve të autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit publik, si dhe afatet e paraqitjes së këtyre ankesave si për dokumentat e tenderit ashtu edhe për procesin e vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu referuar pikës 2 të nenit 111 të nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe

autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Ndërkohë referuar pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 236, datë 20.4.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik*”, është përcaktuar së tarifa e ankesës në rastin e ankesave për dokumenta tenderi është në vlerën 0.4% të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit për të cilën paraqitet ankesa, ndërsa tarifa e ankesës në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit është në vlerën 0.5% të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit për të cilën paraqitet ankesa.

Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

III.1.13. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se autoriteti kontraktor nuk e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “KLAME” SHPK, duke e mos e marrë në shqyrtim atë, në mungesë të elementeve formale, pasi ka kryer paraprakisht procedurën e përcaktuar në pikën 3, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor pasi është njohur me ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK ka konstatuar se objekti i ankesës lidhet me vendimin e vlerësimit të ofertave të komisionit të vlerësimit të ofertave të datës 27.03.2025, për procedurën e ankimit objekt

ankese dhe se vlera e tarifës së pagesës së ankimit të bëra nga ky operator nuk është më e vogël se vlera 0.5% të vlerës së fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sikurse përcaktohet në pikën 2/b të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 236, datë 20.4.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”*, ndaj referuar përcaktimeve të pikës 3, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, autoriteti kontraktor në datë 18.04.2025, ora 13:26 PM, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike në rubrikën *“Komunikime”* i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues *“KLAME”* shpk, që të rregullojë të metat e ankesës, lidhur me pagimin e tarifës së plotë të ankimit në vlerën 0.5% të fondit limit. Në rast se ky i fundit nuk do i korrigjonte mangësitë e konstatuara brenda 2 ditëve nga njoftimi, atëherë autoriteti kontraktor e ka konsideruar ankesën si të paparaqitur.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimet në Sistemin e Ankesave Elektronike, konstaton se në përgjigje të kërkesës së datës 18.04.2025, operatori ekonomik ankimues *“KLAME”* SHPK jashtë afatit 2 (dy) ditor dhe konkretisht në ditën e 7 (shtatë) pas kërkesës së datës 18.04.2025, ka dërguar nëpërmjet këtij sistemi mandat pagesën e datës 25.04.2025, të lëshuar nga OTPBANK, ku ka paguar në favor të Degës së Thesarit Tiranë për llogari të Komisionit të Prokurimit Publik *“Garanci vitit vazhdim pr ankim hyra”* në vlerën 22490 (njëzet e dy mijë e katërqind e nëntëdhjet) leke, për ankesën e sipërcituar.

III.1.14. Në këto kushte Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që nuk ka korrigjuar të metat e ankesës, si në rastin konkret pagimin e plotë të tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Referuar arsytimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar diferencën e tarifën financiare të ankesës brenda afatit 2 (dy) ditor, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ankesa operatorit ekonomik *“KLAME”* SHPK, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj bazuar në germën *“a”* të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e*

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-34898-12-30-2024, me objekt: “Blerje pajisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve mësimore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, me fond limit 22.490.000 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 13.02.2025 nga autoriteti kontraktor Universiteti i Mjekësisë Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

